



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 156, Datë 02.05.2023

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME  
APLIKIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 884/10 prot., datë 28.04.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 64, datë 03.03.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 04.03.2023 dhe 05.03.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.
- Me shkresën nr. 884/3 prot., datë 10.03.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.
- Rezulton se shoqëria nuk ka depozituar ende miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit. Në datën 14.04.2023, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqëritë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. dhe “OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT” (OST) sh.a. dhe nga

përfaqësuesit e shoqërisë në seancë u deklarua se miratimi përfundimtar i pikës së lidhjes është në proces dhe pritet të finalizohet brenda 15 ditësh. Duke qenë se nga shoqëria nuk u depozitua miratimi për pikën e lidhjes, me e-mailin e datës 27.04.2023, iu kërkua asaj të sqaronte fazën në të cilën ndodhej marrja e këtij miratimi dhe shoqëria ka bërë më dije se kërkesa e saj është marrë në shqyrtim nga OST sh.a. dhe se afati i parashikuar për pajisjen me dokumentacionin për “Marrëveshja e Lidhjes” me OST sh.a. parashikohet të jetë brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të këtij e-maili.

- Në nenin 14, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik” e ndryshuar, parashikohet se: bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit që shoqëria duhet të dorëzojë në lidhje me miratimin e operatorit të rrjetit OST sh.a., për lidhjen e centralit fotovoltaik, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës.
- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë pune afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**